



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
**ZYRA E KRYEMINISTRIT/ URED PREMIJERA/ OFFICE OF THE PRIME
MINISTER**

Agjencia për Barazi Gjinore -Agjencia za Polnu Ravnopravnost-Agency for Gender Equality

Shpallet

Thirrje publike për shprehje të interesit për të qenë pjesë e komisioneve vlerësuese për vlerësimin e Projekt propozimeve të OJQ-ve

Datë: 21.03.2024

Bazuar në Thirrjen Publike të datës **20.03.2024** të lëshuar nga Agjencia për Barazi Gjinore / Zyra e Kryeministrit për thirrjen publike për mbështetje financiare për projekte/programe të OJQ-ve, me qëllim të promovimit dhe mbrojtjen e barazisë gjinore, ftojmë organizatat jo qeveritare/shoqërinë civile, të aplikojnë për të marrë pjesë në komisionin e vlerësimit, në cilësinë e ekspertëve të jashtëm, duke përfshirë përfaqësues të OJQ-ve.

Rregullorja MF- Nr- 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në Nenin 8, paragrafi 3.2 parasheh që pjesë e çdo komisioni vlerësueses për vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve të pranuar sipas thirrjeve publike duhet të jenë dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, duke përfshirë përfaqësues të OJQ-ve. Për këtë qëllim, Agjencia për Barazi Gjinore fton të gjithë kandidatët e interesuar që të aplikojnë për të qenë pjesë e komisionit vlerësues si ekspertë të jashtëm, për të vlerësuar projekt propozimet e dorëzuara nga OJQ-të për financim përmes fondeve publike.

Të drejtë aplikimi kanë:

- Të punësuarit në organizatat jo-qeveritare aktive në Republikën e Kosovës;
- Ekspertë të pavarur, cilët kanë të paktën 5 vite përvojë pune që ndërlidhet me administratën publike, hartimin dhe menaxhimin e projekteve apo fusha të ngjashme.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Duhet të kenë të kryer së paku nivelin e studimeve Bachelor;
- Të kenë të paktën 5 vite përvojë pune;
- Të kenë përvojë në projektet e OJQ-ve;
- Të mos jenë të emëruar politikë, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Një letër motivimi
- Një CV të përditësuar;
- Dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës;
- Të punësuarit në OJQ duhet të dorëzojnë një letër nominimi nga Udhëheqësi i OJQ-së në të cilën aplikuesi është i punësuar.

Dokumente e pakompletuar nuk do të shqyrtohen nga ana e komisionit .

Aplikimi mund të bëhet përmes e-mail: Albani.Lumi@rks-gov.net deri me datë 15.04.2024, ne ora 16.00.